VENDIM
Nr.570, datë 23.8.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.335, DATË 20.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja "b" e pikës 12 të vendimit nr.335, datë 20.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Në organin qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin, brenda 5 ditëve pas mbarimit të afatit të ankesës pranë entit prokurues. Organi, qendror apo vendor, është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha